REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr.3282/2 Prot. Patos, më 19/10/2026

NJOFTIM

Dëgjesë publike me temë:
"Miratimi i hartës për dhënien në përdorim të hapësirave publike në territorin e bashkisë Patos"

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe kërkesës me nr. 3282 prot., datë 12.10.2026 me lëndë "Kërkesë për realizimin e konsultimit publik për miratimin e hartës për dhënien në përdorim të hapëirave publike",

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Martë** në datë **17.11.2026 ora 10:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak Patos do të organizohet dëgjesa publike me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; biznese; kryetarë të fshatrave; banorë të njësive administrative; shoqëri civile; institucione publike dhe jopublike, përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi; me temë: **"Miratimi i hartës për dhënien në përdorim të hapësirave publike në territorin e bashkisë Patos".**

Ky konsultim publik synon të njoh grupet e interesit me rregullat dhe kriteret e reja për shfrytëzimin e hapësirës publike si dhe marrjen e mendimeve, sugjerimeve apo komenteve nga subjektet tregtare, qytetarët dhe grupet e interesit.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA PATOS